



**INFORMACIONI PER NDERVEPRIMIN ME
MJEDISIN PER SHFRYTEZIMIN E
MINERALIT GIPS-ALABASTER, LEJA MINERARE
NR. 1331
OBJEKTI “VRENJT, RADOMIRE”
QARKU DIBER**

(Sipas Vendimit nr. 686 datë.29.07.2015)

Subjekti: “KNAUF-ALBANIA” SH.P.K

Përgatiti për “GBA STUDIO”: Msc. Ing.Mjedisi Denisa KOLA



PRIILL 2016

PERSHKRIMI I PROJEKTTI

- 1) Pershkrim i mbuleses bimore**
- 2) Informacion per pranine e burime ujore**
- 3) Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative**
- 4) Pershkrim i shkurter per shkarkimet e mundshme ne mjedis**
- 5) Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve**
- 6) Mundesia e rehabilitimit te mjedisit**
- 7) Masat e mundshme per shmangien e ndikimeve negative**
- 8) Ndikimet e mundshme ne mjedis**

Hyrje

Informacioni per nderveprimin me mjedisin te projektit hartohet ne zbatim te vendimit Nr. 686 nr. 29.07.2015. Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit e Deklarates Mjedisore.

1) Pershkrim i mbuleses bimore

Per nga origjina , perberja dhe vecorite gjeobotanike bimesia e Shqiperise ben pjese ne nenzonen floristike mesdhetare e cila perfshihet ne nje njesi me te madhe, ne zonen holarktike. Ndikim te madh ne zhvillimin e flores mesdhetare ushtroi ftohja e pergjithshme e klimes ne periudhen e pleistocenit dhe akullzimi i fuqishem qe pasoi ate. Tiparet karakteristike te bimesise mesdhetare si per sa i perket vecorive gjeobotanike ashtu edhe perberjes morfologjike dhe shtrirjes vertikale te saj, jane karakteristike edhe per bimesine e vendit tone. Por kushtet konkrete te zhvillimit, sidomos te klimes dhe te relievit kane percaktuar edhe vecorite origjinale te flores se Shqiperise. E gjithë kjo pasuri floristike i detyrohet vecorive te evolucionit paleogjeografik te Shqiperise dhe sidomos larmise se madhe te klimes, copetimit te theksuar te relievit dhe formave te shumellojshme te tij, formacioneve te shumta shkembore (karbonatike, magmatike, terrigjene) etj. Ne rajonin ku ben pjese zona minerare nr. 1331 zoteron bimesia e tipit mesdhetar. Ndryshueshmeria biologjike paraqitet e varfer, flora ne zone eshte me zhvillim te dobet. Rriten kryesisht drure dhe sidomos shkurre me gjethe gjithmone te blerta, qe zakonisht shoqerohen nga bime barishtore mesdhetare , pak a shume te tipit kserofit dhe me nje perqindje te larte (rreth 65%) te formave jetesore terofite.

Me posht paraqiten foto te bimesise qe rritet ne zone



Dushk



Dushk



Shkoze



Lajthi

Fitocenozat e bimesise barishtore shume te larmishme nga perberja e llojeve, gjenden ne te gjitha zonat fitokilmatike te Shqiperise, megjithese fitocenozat barishtore nga ana e fizionomise ne pergjithesi duken relativisht te peraferta, ato ndryshojne midis tyre nga perberja floistike ne varesi te faktoreve ekologjike. Me perjashtime te pakta, gati ne te gjitha fitocenozat dhe bashkeshoqerimet barishtore gjenden perfaqesues te familjes graminore (Graminaceae). Neper shkembinjte gelqerore e sidomos ne te çarat e tyre , rritet nje bimesi e njohur me emrin hasmofite, e perbere nga draba thonjeze (draba aizoides L.), shmanga e baldacit (crepis baldaccii halacsy).



Lepjeta

Bimesia qe rritet ne rajon eshte bimesi qe i pershtatet kushteve te klimes se rajonit, brezit te dushkut , me karakteristike qe rriten ne zone jane: Shkoze (carpinus) Drure ose shkurre me lekure te lemuar te perhime. Sythat majemprehte me melluga te hsumta. Gjethet ne kohën e lulezimit ne zhvillimin e siper. Fryti me peshtjelle te vrigulluar ose te dhembezuara. Gjethet e saj jane ushqim kryesor per blegtorine. Dushk (quercus) Drure , rrale shkurre. Druret me palce yndyrore peskendeshe. Sythet vezengjashem , gjethet te vrigulluara ose te dhembezuara, rrale te plota , renese ose te perhereblerta. Cdo lule rrethohet nga nje peshtjelle qe drunjezohet dhe shoqeron lendet. Dushku gjendet ne disa forma si dushk, lis, qarr etj , ka perdorim gjethet e tyre, lendet kryesisht ushqim per blegtorine, gjithashtu perdoret edhe per ngrohje. Lajthi (corylus) Drure ose shkurre monoike. Gjethet te thjeshta , te kembyera, rnese. Lulet mashkull pa rrethlule nga nje ne sqetullen e cdo brakteje, me gathe cilindrike te varur ato femer me rrethlule te imet, me nga dy ne sqetullen e cdo brakteje, ne lulesa te clirta ose burbuqengjashme. Vezorja e neteshme, dykthinore. Fryti aken , me nje peshtjelle te formuar nga brakteja dhe braktezat rritese. Farat te ngreneshme. Persa i perket bimeve barishtore rritet lepjeta, caj , shpender etj Ne fshatrat perreth zones rriten edhe nje numer i konsiderueshem bimesh frutore si molle, ftonj, dardha, kumbulla, zona njihet edhe per kultivimin bimeve medicinale. Persa i perket flores ne zonen ku do shfrytezohet guri gelqeror si shihet edhe nga fotot e meposhtme ajo paraqitet e zhveshur , vende –vende rriten lajthi dhe dushk te cilat nuk gezojne status te vecante ruajtje.

2) Informacion per pranine e burime ujore

Nga rikonjicioni i kryer ne momentin e fillimit te studimeve dhe te materialeve gjeologjike te marra ne Sherbimin Gjeologjik rezulton se ne zonen minerare nr. 1331 nuk ka burime te ujrave siperfaqesore pasi kjo zone perbehet nga formacione karbonatike te perfaqesuara nga gelqerore me nje mbulesë te vogel . Ne aferi te zones ne studim ne nje perrua ne veri te zones dallojme nje burim te vogel ku nga te dhenat e barinjeve qe kemi takuar ne periudhen e veres thahet ne dimer ai ka uje te vazhdueshem dhe te bollshem.

3) Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative ne mjedis te projektit,perfshire ndikimet ne biodiversitet,uje,tokene,ajer

Ndikimet negative si gjelberimi i zones qe do te preket nga shfrytezimi do te zgjase pasi aktiviteti minerare eshte planifikuar te zgjase per 10 vite por me programin qe do te behet mendojme te kalojme ne rehabilitim progresiv dhe kjo do te filloje me mbielljen e siperfaqeve me peme qe kete vit qe eshte viti i 8 (tete) i lejes. Kurse per sa i perket zhurmave megjithese ato jane te pa perfilleshme ato do te zgjasin per gjithe periudhen 10 vjeçare te jetes se karrieres.

4) Pershkrim i shkurter per shkarkimet e mundshme ne mjedis te tilla si: Ujra te ndotura,gaze dhe pluhur,zhurme,si dhe prodhimin e mbetjeve;

Siperfaqja ne te cilen do te behet shfrytezimi nuk duket nga qendrat e medha te banuara , me perjashtim te rasteve te kalimtareve qe udhetojne ne rrugen prane. . Aktiviteti shfrytezimit me kariere prek perkohesisht peizazhin ekzistues dhe topografine e saj per gjate kryerjes se aktivitetit . Me masat qe do merren per rehabilitimin e saj, gjelberimin me bime qe rriten ne zone, gjate shfrytezimit dhe ne mbyllje te aktivitetit , peizazhi dhe topografia e zones do te permiresohet dukshem do te krijohet nje ambjent panoramik i kendshem per syrin e njeriut dhe çlodhes. Dëmtimi i vegetacionit bimor, sidomos gjatë hapjes se karieres dhe shfrytezimit te shkalles se pare dhe te dyte është faktor negativ. Per nga pikpamja hidrologjike dhe hidrografike objekti i kerkuar ndodhet ne kushte te mira. Nuk vihen re burime natyrale ujrash. Pikerisht ne vendin ku kerkohet te shfrytezohet nuk ka prroska. Kur ka reshje, neper te rrjedhin me rrembim ujra siperfaqesore per shkak dhe te pjerresise mjaft te madhe te terrenit. Persa i perket zbatimit te ketij projekti ndikim negativ do te kete ne ndryshimin e topografise se tokes . Persa i perket cilesise se ajrit ne zone ai konsiderohet me parametra te pranueshem duke qen se ndodhet larg zonave te banuara dhe nuk eshte i ndotur nga veprimtarite e industrise. Edhe zhvillimi i aktivitetit te shfrytezimit nuk do te shkaktoj ndotje te ajrit sepse nuk do te kete emetime te gazeve ndotes. Per sa i perket shkarkimeve te gazeve ato do te jene mosperfillese se ne pune do te jete nje eskavator, fadrome dhe nje makine transporti kurse perdorim te lendeve plasese nuk do te kete. Pluhurat ne kete aktivitet do te jene fare te pakta pasi plura do te kete ne rruget e transportit brenda karrieres por qe eshte menduar te sperkatet me uje vetem ne periudhen e veres.

Zhurmat ne fazen e ndertimit kryesisht vijne : - nga makinerit e perdorura per pastrimin e dheut te sheshit te montimit te kontoniereve, shtrimin e sheshit me cakell, shkarkimin nga makina me vinç e kontoniereve. - nga makinerit qe do perdoren per pergatitjen e shesheve te shkalleve te shfrytezimit te karieres. Gjate fazes se pare te ndertimit paisjet e perdorura do te jene nje eskavator qe do te hap shkallet e karieres dhe makinerit qe do te perdoren per montimin e kontoniereve me kohe teper te kufizuar pune deri dy dite si kamioni transportit te kontoniereve, vinci shkarkimit dhe fadroma e pastrimit dhe shtrimit te sheshit te kontoniereve.

Zhurma gjate fazes se shfrytezimit

Ndikim te zhurmave do te kete gjate procesve te punes se shfrytezimit. Niveli i zhurmave te ketyre makinerive , eshte i atij niveli qe nuk influencon si per te punesuarit dhe per banoret dhe gjallesat per rreth tij. Niveli zhurmave nga puna e njekoheshme e makinerive ne distance 7 m nga to, eshte me i vogel se 70 dB. Duke mare parasysh shprehjen e nivelit te intensitetit akustik te nje zhurme me relacionin e me poshtem :

$$L = 10 \lg(I_1/I_0) \text{ ku}$$

L - Niveli akustik i zhurmes te marre ne konsiderate .

I_1 - Intensiteti akustik i zhurmave

I_0 - Intensiteti akustik i references

Vleresojme se niveli akustik i zhurmes ne rruge eshte me i ulet se ai i zhurmes se nje makine qe kalon ne te, praktikisht ai eshte 40-50 dB qe i pergjigjet kushteve te nje bisede me ze normal. Fenomene te tilla si vibracion, ndricim, nxehtesia jane te paperfillshme ne zhvillim te ketij aktiviteti ne kete objekt. Duhet theksuar qe vibracioni ne kete aktivitet nuk ndikon ne

territor mbasi nuk ka objekte te cilat ndihet influenza e minave. Siç thame edhe me siper, zhurmat qe do te krijohen gjate procesit te punes ne objekt jane vetem ato te shkaktuara nga makinerite e shfrytezimit ,te ngarkimit e te transportit te cilat ato jane brenda normave.

Depozitimet e sterileve

Ne vendet e caktuara ne projekt (depozitat e sterileve) parashikohet depozitimi i materialit te papedorshem dhe perpunimi i tij me toke vegjetale per te mundesuar mbjelljen e bimeve dhe pemeve karakteristike te zones gjate fazes se rehabilitimit. Dherat e depozituara ne damba do te perpunohen me dhera te pasuruara me humuse, do te transportohen dhe shperndahen ne sheshet e shkalleve me trashesi mbi 20 cm dhe do te pyllezohen me bime qe riten ne zone per gjelberimin e saj.

5) Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve dhe

Mundesia e rehabilitimit te mjedisit

Rehabilitimi i plote i mjediseve te territorit do te jete si me poshte: Mbjellja e taracave

Per regjenerimin e pejsazhit jane marre masa dhe eshte parashikuar projekt i veçante per te. Me fondet qe do te depozitohen subjekti per garanci rehabilitimi regjenerimi i pejsazhit do te rregullohet. Gjate punes, nuk do te kete ndotje te çfaredo lloji te zones. Mbas shfrytezimit, eshte planifikuar marrja e masave dhe shpenzimet perkatese per rigjenerimin e mjedisit dhe rregullimin e pejsazhit.

Masat per rigjenerimin hap pas hapi, krahas shfrytezimit te vendburimit konsistojne ne:

1. Krijimin e siperfaqeve per mbjellje;
2. Sistemimin e materialit te mbuleses te depozituar paraprakisht ne kufijte e karrieres;
3. Mbjelljen e siperfaqeve te reja me fidane pise dhe barishte te ndryshme;
4. Mirmbajtjen e siperfaqeve te mbjella;

Siperfaqja horizontale qe do te rigjenerohet ne kete objekt gjate gjithë aktivitetit te tij do te jete **0.223483 km²**, ku perfshihen rehabilitimi i sheshit te karrieres, sheshit te depozitimit te zbulese dhe rehabilitimi i siperfaqes se trenshese se brendshme.

Kujdesi per punimet reabilituese nga ana e shoqerise "KNAUF-ALBANIA" sh.p.k do te vazhdojne te pakten deri ne kater vite pas mbarimit perfundimtar te shfrytezimit te materialit Gips-Alabaster.

Planifikimi i zones;

Per shmagen dhe parandalimin e erozinit, shembjes se siperfaqes dhe vithisjeve te ndryshme, ne projekt eshte percaktuar shfrytezimi harmonik dhe i kombinuar ne kohe dhe hapësire i zones ne terresi dhe etazheve te ndryshme te shfrytezimit ne veçanti.

Sistemimet, ndertimi i rruges lidhese, hapja dhe fillimi shfrytezimi i karrieres parashikohet te behet qe ne vitin e pare, pas marrjes se lejes minerare te shfrytezimitdhe te vazhdoje mbi 35 vjet. Ne zonen e shfrytezimit hap pas hapi dhe ne perfundim te aktivitetit eshte parashikuar mbushja sistemimi, perpunimi dhe mbulimi i nje siperfaqeje prej rreth **0.223483 km²**. Gjate ushtrimit te aktivitetit dhe kryesisht ne vitet e fundit te tij, parshikohet trajtimi i te gjithë siperfaqes se shfrytezuar.

Kjo siperfaqe e perfituar nga trajtimet e mesiperme do te jape mundesi minimale per rikultivimin e bimeve dhe pemeve te ndryshme lokale, duke krijuar kushte per parandalimin e erozionit dhe permiresimit te pamjes se pergjitheshme te zones se shfrytezuar.

Gjate ushtrimit te aktiviteti te tij, subjekti i licensuar do te kryeje çdo vit proceset e me poshteme:

- Sistemimin e skarpateve perfundimtare te etazheve te shfrytezimit duke respektuar parametrat gjeomekanike dhe gjeometrike te tyre;
- Lenien e brezave mbrojtes midis kufijeve te zones se shfrytezimit dhe siperfaqes tjeter (jashte kufirit te zones);
- Sistemimin, perpunimin dhe mbulimin e siperfaqeve horizontale te etazheve duke i kthyer ato ne forme brezaresh;
- Krijimin e kushteve te pershtateshme per mbjelljen dhe kultivimin e bimeve dhe pemeve te ndryshme lokale;
- Mbjelljen e siperfaqeve te etazheve me bime dhe peme, kryesisht me pisha dhe bime te tjera, te cilat jane karakteristike per zonen.

Plani i monitorimit te mjedisit

Per keto tip karrierash, eshte e domosdoshme qe nga shoqeria qe kryen punimet ne bashkepunim me institucione te specializuara, te programohet monitorimi nga ndotja. Megjene se kemi te bejme me shfrytezimin e gipseve ne siperfaqe ne shpatin e nje kodre dhe ne thellesi te saj nevojitet nje monitorim i vazhdueshem jo vetem ne siperfaqen e vendburimit qe do te shfrytezohet por dhe ne nje zone mbi 300 m perrreth.

Plani i monitorimit do te konsistoje ne:

- Monitorimi i parametrave gjeometrike te etazheve te shfrytezimit si: **pjertesi, lartësia, kendi i skarpates, pjertesia e sheshit te punes si dhe parametrave gjeometrike te parashikuar ne projekt.**
- Monitorimi i sjelljes se formacioneve ne kufijte e jashtem te karrieres dhe marrja e masave per parandalimin e levizjeve te mundeshme si **shkarje, shembje ose vithisje.**
- Monitorimi i zones se mundeshme te shperndarjes se pluhurit gjate aktivitetit te shfrytezimit.
- Monitorimi i parametrave fizike dhe dinamike te shperndarjes se pluhurit dhe marrja e masave perkatese te parashikuara ne projekt, per parandalimin e tij
- Monitorimi i sjelljes se bimesise ekzistuese ne zonen per rreth karrieres dhe marrja e masave per parandalimin e demtimit te tyre.

- Monitorimi i siperfaqeve te mbushura me material dhe toke vegjetale per parandalimin e shplarjeve, gryerjeve, krijimin e gropave etj. Atje ku evidentohen demtime te kesaj zone do te merren masa per riparimin e tyre.
- Monitorimi i cilesise se ajrit dhe permbajtjes se pluhurave.
- Riaftesimi i zonave te shfrytezuara per te mos humbur vlerat fillestare gjeografike dhe gjeologjike.
- Ndertimi dhe ruajtja e brezave te sigurimit.
- Sistemi i ujerave te bardha.
- Eliminimi i derdhjes se ujerave dhe karburanteve ne siperfaqen e tokes.
- Monitorimi i transportit te materialit gjate levizjes se automjeteve te cilat te jene te mbuluar.
- Emetimi i gazrave dhe zhurmave te makinerive ne ajer te kontrollohet nje here ne vit.
- Monitorimi i siperfaqeve te mbjella, pemeve dhe bimeve te kultivuara, ecurise normale e mbirjes dhe zhvillimit te tyre. Ne rastet kur verehet se ka demtime merren masa per zevendesime me fidane te rinj. Monitorimi i çdo siperfaqe te mbjelle do te vazhdoje per nje periudhe 4 vjeçare, kohe gjate se ciles bimet kane mare nje zhvillim te konsiderueshem dhe nuk kane me nevoje per sherbime.

Shoqeria merr persiper sigurimin e ecurise normale te punes dhe ruajtjen e vazhdueshme te mjedisit deri ne mbylljen e aktivitetit. Shoqeria, gjithashtu, do te kete lidhje te vazhdueshme me Drejtorine Rajonale te Mjedisit Diber dhe Agjensine Kombetare te Mjedisit Tirane, prane te ciles do te informoje periodikisht per mbarvajtjen e punes si gjate shfrytezimit ashtu dhe per minitorimn e parametrave te me siper.

6) Masat e mundshme per shmangien e ndikimeve negative

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate punimeve, ne ajer, te pluhurave dhe zhurmave, si dhe uljen e efekteve negative hapsinore te territorit , faunen dhe floren. Por pikesynimi i studimit mbetet rehabilitimi i tokes dhe evitimi ne maksimum i erozionit.

Humbje e pjeresise se tokes

Ne projekt, pjeresia skarpatave te etazheve eshte parashikuar te jete **40-60°**. Kjo pjeresi eshte me e madhe se ajo natyrale e terenit te vendburimit. Mbas sistemimit perfundimtar dhe mbushjes do te tentohet qe ajo te ulet edhe 10o te tjera. Humbja e pjeresise se tokes nga shfrytezimi do e jete e konsiderueshme.

Dëmtimi i florës. faunës dhe bimët e ujit dhe masat parandaluese e rehabilituese;

Zona eshte pergjithesisht e zhveshur nga bimesia mbasi eshte gips alabaster nje pjese shume vogel eshte e pyllezuar mbasi eshte e mbuluar me toke vegjetale. Mbas shfrytezimit, eshte parashikuar mbulimi i siperfaqes se karrieres me toke vegjetale, per te krijuar mundesine e vete pyllezimit. Nderkohe, ne sheshin e poshtem te karrieres dhe ne brezat e sigurimit do te

mbillen fidane te ndryshem pyjor. Ne teresi, as ne floren dhe as ne faunen e zones, shfrytezimi ne kete vendburim nuk do te kete ndikim. Ne zonen e parashikuar per shfrytezim, nuk ndodhen bime uji mbasi argjilat jane ekran izolues per burimet e ujit. Zona eshte ne terren me kullote pa basene ujore, apo liqene, prandaj nga ky aktivitet nuk do te kete demtime te tyre dhe rrjedhimisht, as masa mbrojtese per to. Ne territorin e zones eshte nje perrua i cili do te mbrohet nga shfrytezimi por edhe rreth tij nuk ka bime uji. Ne zonen e shfrytezimit nuk ka ndonje lloj ose specie flore apo faune qe mbrohet me sataus te veçante. Flora dhe fauna lokale nuk do te preket nga shfrytezimi, pasi siperfaqja e vendburimi eshte pothuajse e zhveshur nga bimesia. Rrigjenerimi i karrieres do te mundesoje mbjelljen e bimeve lokale kryesisht pishe e bute, dushk etj.

Dëmtimi i sipërfaqes se tokës. Erozioni gjate hapjes dhe kryerjes se punimeve dhe masat për dëmtimet te sipërfaqes se tokës nga operacionet e gërmimit

Vendburimi, ku do te kryhen punimet, ndodhet ne nje zone qe pjeserisht eshte shkembore me gips alabaster dhe formacionet anesore jane ne masen me te madhe argjilore dhe shume pak gelqerore. Keto formacionet shkembore jane gelqeror, argjila pa gips alabaster dhe jane te forta si dhe argjila te buta. Ne keto kushte, gjate hapjes dhe shfrytezimit, nuk ka arsye te kete erozion (gerryerje) te zones. Ne pjesen qe eshte e bute do te merren masa ndaj erozionit dhe kendi i pjerresise etazheve eshte marre sa kendi i ferkimit te brendshem te ketyre formacioneve. Ne karriere, gjate ndertimit te saj dhe gjate shfrytezimit, nuk do te kete demtime dhe humbje te siperfaqes se tokes per kullote mbasi ajo do te rehabilitohet. Karriera eshte vendosur ne zone mjedisore kullote. Vendburimi, ku do te shfrytezohet gips alabastra, do te shoqerohet me germime per hapjen e transheve dhe shfrytezimin e tij. Mbas shfrytezimit, pjerresia e shpatit do te jete me e madhe se pjerresia natyrale, por gjithmone, brenda kufijve te levizjes natyrale te formacionave ne pjesen veriperendimore dhe jugore-lindore dhe me e vogel se pjerresia natyrale ne pjesen veriore dhe jugore. Siperfaqja qe do te germohet do te rehabilitohet me material qe do te dali nga zbulimi i gips alabastres. Siperfaqja e shfrytezuar nuk eshte e kultivueshme dhe nuk perfaqeson ndonje kullote shume te dobishme pasi masiv gipsit teresisht e zhveshur. Ne prefundim te shfrytezimit kjo siperfaqe do te sistemohet dhe mbillet me qellim riperdorimin e saj. E gjithë zona do te mbulohet me formacionet deluviale te zbulimit duke mundesuar keshtu, pas perpunimit, kultivimin e pemeve te ndryshme locale dhe barishteve. Si rrjedhim pas shfrytezimit nuk do te kemi humbje te siperfaqes per kullote. Ne projekt eshte parashikuar nje radhe dhe drejtimi i tille i shfrytezimi, qe ne kombinim me masat e tjera suplementare te mbushjes, sistemimit dhe trajtimit, parandalojne erozionin, shembjen dhe vithisjen e shapateve te karrieres dhe siperfaqes se livadheve rreth saj.

Masat për rigjenerimin e peisazhit;

Per regjenerimin e pejsazhit jane marre masa dhe eshte parashikuar projekt i veçante per te. Me fondet qe do te depozitoje subjekti per garanci rehabilitimi regjenerimi i pejsazhit do te rregullohet. Gjate punes, nuk do te kete ndotje te çfaredo lloji te zones. Mbas shfrytezimit, eshte planifikuar marrja e masave dhe shpenzimet perkatese per rigjenerimin e mjedisit dhe

rregullimin e pejsazhit. Masat per rigjenerimin hap pas hapi, krahas shfrytezimit te vendburimit konsistojne ne:

- 1.Krijimin e siperfaqeve per mbjellje;
2. Sistemimin e materialit te mbuleses te depozituar paraprakisht ne kufijte e karrieres;
- 3.Mbjelljen e siperfaqeve te reja me fidane pishe dhe barishte te ndryshme;
- 4.Mirmbajtjen e siperfaqeve te mbjella;.

Siperfaqja horizontale qe do te rigjenerohet ne kete objekt gjate gjithë aktivitetit te tij do te jete **0.223483 km²**, ku perfshihen rehabilitimi i sheshit te karrieres, sheshit te depozitimit te zbulesese dhe rehabilitimi i siperfaqes se trenshese se brendshme.

7) Ndikimet e mundshme ne mjedis

Objekti eshte ne brendesi te territorit te vendit dhe nuk ka ndikime nderkufitare.

